



Drejtorati për Inspekcione

10 Nr. ____ /2022

Dt. 12 / 07 /2022

Për: Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës

Nga: Halil Tolaj – Drejtor i Drejtoratit për inspekcione

Lënda: Raport i punës së Drejtoratit për Inspekcione për gjashtëmujorin e parë 2022.

Drejtorati për Inspekcione i Komunës së Deçanit gjegjësisht inspektorët e këtij Drejtorati, gjate gjashtëmujorit të parë të vitit kalendarik 2022 kanë kryer kryer punët dhe detyrat e punës konform Ligjeve dhe akteve nënligjorë si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2022.

Në Kuadër të Drejtoratit gjatë këtij gjashtëmujori kanë qenë të sistemuar Inspektori i Tregut, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë mbi shërbimet e Veçanta), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shef i inspektorëve.

Që nga viti i kaluar inspektori Sanitar ka kaluar në Agjensionin e Veterinës dhe Ushqimit dhe prej atëherë nuk ka Inspektor Sanitar në nivelin Komunal.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente. Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore, ndërtimet pa leje apo në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në mënyrë permanente është ber kontrolli i therjes së kafshëve në thertoret e licencuara.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe te mbrojtjes në punë.

Janë bere kontrole sipas kërkesës së Policisë së Kosovës (me të cilët ekziston një bashkëpunim mjaft i mirë), posaçërisht për mallrat e hasura ne transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse, mosrespektimin e orarit të punës sidomos nga subjektet hoteliere, por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa

rregullsitë e hasura te subjektet tregtare sidomos nga lëmi i çmimeve dhe afati i skadimit të artikujve ushqimor.

Janë kryer edhe punë tjera sipas fushe veprimtarisë të secilit nga inspektorët. Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:

Inspektori	Kontroll inspektuese në teren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektuese në teren sipas kërkesës se personave fizik dhe juridik	Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktvendime	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	26	16	64	8	4
I Ndërtimit	26	14	23	7	2
I Mbrojtjes se Ambientit					
I Veterinës	31	8	28	/	1
I bujqësisë	10	12	12	2	/
Gjithsejt:	93	50	127	17	7

Inspektorja e Ambientit deri në momentin e përpilimit të këtij raporti nuk ka raportuar për punën e saj.

Kërkesë: Duke pas parasysh situatën lidhur me ndërtimet në komunën e Deçanit është mese e domosdoshme zgjidhja e çështjes së Inspektorit të ndërtimit.

Drejtori

Halil Tolaj